

316.344.5:343

Doc.dr. Mevledin MUSTAFI<sup>1</sup>

**SIGURIA PUBLIKE DHE FUNKSIONET E SË DREJTËS PENALE  
NË MBROJTJE TË SHOQËRISË BASHKËKOHORE**

**ЈАВНАТА БЕЗБЕДНОСТ И ФУНКЦИИТЕ НА КАЗНЕНОТО  
ПРАВО ВО ОДБРАНА НА СОВРЕМЕНОТО ОПШТЕСТВО**

**PUBLIC SECURITY AND THE FUNCTIONS OF THE CRIMINAL  
LAW IN DEFENDING THE COTEMPORARY SOCIETY**

*Siguria është detyrimi i parë i një Shteti<sup>2</sup>*

**Abstract**

Human society since the genesis of human survival is faced with various threats and are caused significant damages to people and significant damages as cause of the suffering of humanity. Human society faced many wars where were killed millions of people and were spent a lot of time to understand that only cooperation and tolerance will save humanity. In the historical development of society it is impossible to find instance of shaping and structuring of communities that existed in longer periods of time, but they had no need for any form of defense organization. In this way of modern, legal and civic society construction, community members have sought and have expressed the need for security, namely the elimination of all forms of risk, which can lead to question mark the fundamental rights and freedoms of physical integrity, privacy, dignity, security, wealth etc. Viewed in this light, we can emphasize that safety is the basic function of any state, because without

---

<sup>1</sup> Profesor universitar dhe funksionar i lartë në Ministrinë e punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë.

<sup>2</sup> [Michelle Alliot – Marie](#).

an adequate level of safety cannot be spoken for democratic power or for social stability in general. Also, cannot be talked about legal system without democracy and system of freedoms and human rights, nor for security stability without shaping the relevant institutions that protects them. So, security is one of the fundamental preconditions for the existence of the social community.

**Keywords:** Safety, security, public safety, criminal acts, crime, criminality, human life, killings, criminal justice functions, protection of contemporary society and human rights, existence of social community, international protection etc.

### **Abstrakt**

Shoqëria njerëzore që nga zanafillat e para të mbijetesës njerëzore është përballuar me kërcënime të ndryshme dhe janë shkaktuar dëme të mëdha në njerëz dhe dëme të mëdha si shkaktar të vuajtjes së njerëzimit. Shoqëria njerëzore u përball me shumë luftëra ku humbën jetën me miliona njerëz dhe kaloi shumë kohë për të kuptuar se vetëm bashkëpunimi dhe toleranca do të shpëtojë njerëzimin. Në zhvillimin historik të shoqërisë është e pamundur të gjenden instanca të formësimit dhe strukturimit të bashkësive që kanë ekzistuar në periudha më të gjata kohore, por nuk kanë pasur nevojë për ndonjë formë të organizimit mbrojtës. Në këtë rrugë të ndërtimit të shoqërisë bashkëkohore, juridike dhe qytetare, anëtarët e bashkësisë kanë synuar dhe kanë shprehur nevojën për siguri, gjegjësisht për eliminimin e të gjitha formave të rrezikut, i cili mund të vë në pikëpyetje të drejtat dhe liritë themelore integritetin fizik, privatësinë, dinjitetin, sigurinë, pasurinë, etj. Shikuar në këtë prizëm, mund të theksojmë se siguria është funksioni themelor i secilit shtet, për shkak se pa një nivel përkatës të sigurisë nuk mund të flitet as për pushtet demokratik, as për stabilitet shoqëror në përgjithësi. Gjithashtu, nuk mund të flitet për sistem juridik pa kraci dhe sistem të lirive dhe të drejtave njerëzore, as për stabilitet të sigurisë pa formësimin e institucioneve përkatëse që i mbron ato. Pra, siguria është një prej parakushteve fundamentale për ekzistencën e bashkësisë shoqërore.

**Fjalët kyçe:** Siguria, sigurimi, siguria publike, veprat penale, krimi, kriminaliteti, jeta e njeriut, vrasjet, funksionet e së drejtës penale, mbrojtja e shoqërisë bashkëkohore të drejtat e njeriut, ekzistenca e bashkësisë shoqërore, mbrojtja ndërkombëtare etj.

### **1. Shoqëritë kanë kaluar dhe sot, gjatë zhvillimit të vet, në mënyrë permanente kalojnë nëpër konflikte**

Vështruar historikisht, të gjitha shoqëritë kanë kaluar dhe sot, gjatë zhvillimit të vet, në mënyrë permanente kalojnë nëpër konflikte të ndryshme, politike, ekonomike dhe ushtarake e të sigurisë, të cilat, sipas mënyrës së manifestimeve, intensitetit dhe pasojave ndikojnë dukshëm në ashpërsimin gjithnjë e më të madh në këtë fushë. Në çdo shoqëri të konsoliduar interesat politike, të sigurisë e të tjera të qytetarëve ndryshojnë e transformohen nga dita në ditë dhe fitojnë përmbajtje të reja, në pajtim me transformimin e përgjithshëm të civilizimit. Në këtë rrugë shfaqen sfida të ndryshme dhe forma të ndryshme të destruksionit, burime të ndryshme të rrezikut të cilat marrin karakter global dhe vënë në pikëpyetje ekzistencën dhe mbijetesën e njerëzimit. Përveç kësaj, format dhe instrumentet e ndryshme të dhunës nëpërmjet terrorizmit, krimin të organizuar, narkomanisë, mjeteve për zhdukje dhe shkatërrime masive, pa dyshim shprehin gjithë kompleksitetin e qenies së sotme njerëzore.<sup>3</sup>

### **2. Kërcënimet dhe koncepti mbi kërcënimet ka ndryshuar në atë masë sa që Studimet e Sigurisë përfshijnë brenda tyre rreziqe që variojnë**

Kërcënimet dhe koncepti mbi kërcënimet ka ndryshuar në atë masë sa që Studimet e Sigurisë përfshijnë brenda tyre rreziqe që variojnë nga epidemitë si HIV-SIDA dhe degradimi mjedisor, deri dhe te shqetësimet sigurie e lidhura me dhunën e drejtpërdrejtë, si terrorizmi dhe konflikti ndërshtetëror. Ky i fundit, që ka dominuar kaq shumë disiplinën sa që gjatë Luftës së Ftohtë u bë sinonim i Studimeve të Sigurisë, është aktualisht një nënfushë e Studimeve të Sigurisë, e njohur si Studime strategjike për sigurinë e shoqërisë bashkëkohore.<sup>4</sup> Sikurse mund të vihet re në studimet bashkëkohore të Sigurisë, janë të mendimit të përbashkët shumë studiues të sigurisë për arritjen e një konsensusi të

---

<sup>3</sup> Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi "Sistemet e sigurisë –Sisteme security", f.19-37 Furkan ISM Shkup, 2016

<sup>4</sup> Hobsi i ka kushtuar rëndësi të posaçme edhe masave me karakter sigurie. Në të vërtetë, me qëllim të kapërcimit të frikës nga situata e natyrshme, gjegjësisht për stabilitetin e konstruksionit të shtetit është vendimtare situata e sigurisë shtetërore. Meqë gjendje e natyrshme është që secili për secilin të jetë armik, vetëm qytetarët e shtetit juridik janë të sigurt për ekzistencën e tyre fizike dhe në këto shtet mbretëron rendi dhe qetësia.

përbashkët ndërkombëtar mbi përmbajtjen e sigurisë se ajo ka të bëjë me kërcënimet ndaj mbijetesës.

Nga ana tjetër ajo çka është më e habitshme se brenda këtij përkufizimi të thjeshtë shtrihet kompleksiteti që do të zbulojnë shkencat e sigurisë nga edhe do të flasim në vazhdim të këtij studimi shkencor të lëmisë së Sigurisë, në vijim do të mund të gjeni edhe qasje alternative ndaj sigurisë, qasje që ofrojnë objekte të ndryshëm referues, mjete të ndryshme për arritjen e sigurisë, të cilët tregojnë se praktika e kaluara, në vend të forconin sigurinë, kanë qenë shkak i pasigurisë. Vetë zhvillimi i sigurisë, kushtet e shfaqjes së tij si dhe format e ndryshme të organizimit, janë kushtëzuar nga zhvillimi i shoqërisë njerëzore. Ai ka lëshuar rrënjë që para ekzistimit të shtetit, pra edhe të normave politiko-juridike, kur të gjitha shoqëritë kanë pasur formë të thjeshtë integrimi. Në shoqëritë paramoderne siguria është realizuar bë bashkësitë e lidhura organike sociale. Ka qenë obligim i sunduesit që vartësve të tij t'u krijojë sigurinë e nevojshme për përmbushjen e nevojave të tyre, ndërsa obligim i vartësve ka qenë t'i përulën autoritetit të tij. Në këto, t'i quajmë, segmente të shoqërisë, farefisnia ka pasur karakteristikat e strukturës dhe funksionit themelor të rregullimit moral të marrëdhënieve të përgjithshme në bashkësi, me vështrim të veçantë në komponentën e sigurisë, si faktor i preventivës gjenerale për parandalimin e formave të ndryshme të dhunës.

Meqenëse të gjitha këto bashkësi të vogla me strukturën dhe sistemin e tyre të thjeshtë të kontrollit shoqëror kanë filluar të ndryshojnë, gjegjësisht të evoluojnë në grupime të mëdha, gjithnjë e më shumë është shfaqur nevoja për forma të reja të rregullimit dhe mbrojtjes, në kuptimin e sigurisë. Në këtë kuptim, në shoqëritë e kohëve më të lashta siguria paraqitet si bartës kryesor i rregullimit të ndikimit sistemor legjitim në sjelljen e njerëzve ndaj kritereve të caktuara që më parë të sjelljes brenda të njëjtës bashkësi.

Më vonë, siguria paraqet gjithnjë e më shumë formën e institucioneve dhe sistemit. Në historinë e zhvillimit njerëzor, janë të rralla nocionet që janë përmendur aq shumë dhe që nuk janë definuar sa nocioni i sigurisë. Ekziston një sere mendimesh teorike mbi përdorimin e vetë nocionit dhe një sërë vështrimesh të ndryshme shkencore për sigurinë, sidomos nëse kemi parasysh se ky nocion përdoret si vlerë themelore e marrëdhënieve ndemjet njerëzve në të gjitha fushat e jetës dhe të punës. Këtu buron edhe nevoja e përdorimit të shumë shtresor të këtij nocioni, i cili ka qëllim themelor ruajtjen dhe sigurinë e qytetarëve.

Funksioni kryesor i së drejtës penale është mbrojtja e individit dhe shoqërisë nga sjelljet me të cilat sulmohen liritë dhe të drejtat individuale dhe funksioni i përbashkët i jetës, apo me fjalë të tjera, funksioni mbrojtës i së drejtës penale është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti.<sup>5</sup>

### **3. Kriminaliteti si dukuri shoqërore është lëndë e kontrollit permanent social**

Pjesën joformale të shoqërisë e përbëjnë segmentet e ndryshme të ngushta dhe të gjera të shoqërisë: familja, shkolla, publiku, mediumet etj. Pjesën formale ose instrumentale të kontrollit social të kriminalitetit e përbëjnë instrumentet e ndryshme juridiko-rregullative të planit për parandalimin e kriminalitetit dhe represionit: policia, prokuroria, gjykatat, burgjet etj. E drejta penale e përcakton bazën dhe kornizën e pjesës juridike instrumentale, si dhe përmbajtjen dhe kufijtë e zbatimit të detyrimit shtetëror në pengimin e kriminalitetit. Mbrojtja e individit dhe shoqërisë nga kriminaliteti me ndihmën e së drejtës penale realizohet me shpalljen e sjelljeve të përcaktuara si vepra penale dhe sanksione tjera për ato vepra. Ajo është funksioni mbrojtës i parandalimit të së drejtës penale. Të vënët e ndalesave penalo-juridike për sjelljet e përcaktuara dhe përcaktimi i dënimit për shkeljen e tyre ka për qëllim ta legjitimojë, nga njëra anë të drejtën e shtetit për dënim dhe nga ana tjetër t'i frikësojë kryesit e veprave penale, se në rast të mosrespektimit të tyre do të privohen nga ndonjë e drejtë kryesore të tyre si lloj dënimi apo ndonjë sanksionim tjetër. Arsyeja kryesore për vënien e ndalesave penalo-juridike (kriminalizim) dhe përcaktimit të dënimeve (penalizim) gjendet në pritje se me respektimin e tyre do të sigurohet pranimi dhe përkrahja e vlerave individuale dhe shoqërore. Baza e tillë mbrojtëse ose shkaku (*ratio legis*) për ndalesat ligjore është fija themelore që i lidhë dispozitat ligjore me zbatimin e tyre në praktikë (*Mayaud*, 598). Për ta realizuar funksionin e vet parandalues ndalesat penalo-juridike duhet të jenë të qarta dhe të njohura për secilin. Pranë veprimit kërcënues, proklamimi i tyre vlerëson edhe në ndikim përkatës mbi bindjen morale, vetëdijen juridike dhe lojalitetin juridik të qytetarëve. Ai është funksioni rregullativ i së drejtës penale, që mund të realizohet nëse kodi penal miratohet nëpërmjet procedurës demokratike, nëse shkon nga vlerat e përcaktuara të përhershme dhe gëzon përkrahje të përgjithshme.

<sup>5</sup> Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi "Sistemet e sigurisë –Sisteme security", f.19-37 Furkan ISM Shkup, 2016

#### **4. Funkzioni mbrojtës i së drejtës penale është fragmentar, ngase me këtë degë të drejtësisë mbrohen vlerat më të rëndësishme, më elementare të individit dhe bashkësisë.**

Funksioni mbrojtës i së drejtës penale është fragmentar, ngase me këtë degë të drejtësisë mbrohen vlerat më të rëndësishme, më elementare të individit dhe bashkësisë. Mbrohen ato vlera, apo të mira juridike, të cilat janë të domosdoshme për ekzistencën e shoqërisë dhe të individëve, duke marrë parasysh intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore, mënyrën e kryerjes, shkallën e fajësisë etj. Këtu fjala vjen, nuk konsiderohet si veprë penale çdo shkelje e detyrimeve familjare, por vetëm shkelja e rëndë, me ç'rast lihet në pozitë të vështirë anëtar i familjes që nuk është në gjendje të kujdeset për vete. Kuptohet se e drejta penale nuk është disiplinë pedagogjike, që veprimin e vet mbrojtës e realizon me moralizim ose bindje se ligjet duhet të respektohen! Thyerja është nëna e ligjeve, ato ekzistojnë mu për sjelljet arbitrare me të cilat shkelen apo rrezikohen vlerat mbrojtëse. Prandaj, në rast të shkeljes së ndalesave penalo-juridike vjen deri te aktivizimi i së dytës, anës represive të mbrojtjes penalo-juridike. Represioni penal juridik përbëhet nga zbatimi i dënimit ose sanksioneve tjera ndaj kryesit pas veprës së kryer penale (*ex post*).

Përmbajtja e vetë ndalesës realizohet me shpalljen e kryesit të veprës si përgjegjës dhe me zbatimin e dënimit ose ndonjë sanksioni tjetër. Përmbajtja e sanksionit penalo-juridik është përvetësim i detyrueshëm nga ana e shtetit, si reaksion i veprës së kryer pas lirive dhe të drejtave të përcaktuara të kryesit. Mbrojtja penalo-juridike aposteriore nuk ka asses veprim të drejtpërdrejtë në lidhje me mbrojtjen e vetë së mirës që rrinë pas ndalesës penalo-juridike, për arsye se ajo shpeshherë është si e humbur! Vallë, si e mbrojmë jetën e njeriut duke dënuar vrasësin? Kuptimi i represionit penalo-juridik përbëhet nga pengimi i shkeljeve të ardhshme të të mirave mbrojtëse: duke e dënuar vrasësin e riafirmojmë të drejtën e jetës, duke ia bërë me dije çdokujt se çfarë pasoja e presin. Nga kjo përbëhet specifikimi i funksionit mbrojtës parandalues të së drejtës penale: parandalues mbi represionin, me kërcënimin e kryesit që në të ardhmen mos të bëjë vepra penale, risocializimi i tij dhe kërcënimi i kryesve tjerë. Mbrojtja penalo-juridike mund të arrijë veprim represiv- parandalues nën dy kushte: nëse është efikase, që do të thotë se duhet të përbëhet nga zbatimi i masave me efekte të vërtetuara parandaluese; dhe dy, nëse është e njohur, e pashmangshme, nëse i godet kryesit e të gjitha veprave të kryera pa asnjë përjashtim.

Fakti se mbrojtja aposteriore penalo-juridike realizohet me vënien dorë pas të drejtave dhe lirive më të rëndësishme njerëzore, krijon një kontradiktë të rrejshme të brendshme: e drejta penale nga njëra anë paraqitet si instrument i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave, kurse nga ana tjetër si mjet i depërtimit në to me zbatimin e dënimit dhe sanksioneve tjera.

Nuk ka asnjë kundërthënie, po qe se shkohet nga postulati në vijim: në vënien e sistemit dhe përmbajtjes së dënimit dhe sanksioneve tjera, respektivisht në vënien dorë pas të drejtave dhe lirive të kryesve të veprës, e drejta penale duhet të mbahet për kriteret e njëjta të vlerave, që e afirmojnë dhe e promovojnë konceptin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Pa respektimin e postulatit të këtillë, që rezulton me dyshim apriori në arsyetimin e represionit penalo-juridik ekstensiv dhe tepër të ashpër, e drejta penale bie në *hipokrizi*: atë që do ta afirmojë si objekt mbrojtjeje ta shkatërrojë me vënien e instrumenteve mbrojtëse. Mbrojtja optimale e lirive dhe të drejtave mund të realizohet vetëm me zbatim racional dhe të kufizuar të zaptimit të detyrueshëm pas të të njëjtave liri dhe të drejta! Mjeti, dënimi dhe sanksionet tjera duhet të jenë të harmonizuara me qëllim - mbrojtjen e lirive dhe të drejtave.

Në dritën e kësaj qasje mund të sqarohet edhe aspekti i dytë i funksionit mbrojtës të së drejtës penale: funksioni i saj *garantues*, respektivisht *ai shtetëror juridik*. Ideja për ligjin penal si "*Magna Charta Libertatum*" është më e vjetër së një shekull (autor i saj është teoricieni gjerman *Liszt*, II, 80). Kjo ide fitoj përmbajtje konkrete dhe reale në gjysmën e dytë të shek XX me meritë të dy faktorëve: rumbullakimi i korpusit universal të të drejtave të njeriut dhe paraqitja dhe zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare si e drejtë supranacionale. Nga proceset e tilla rezultonte pranimi i më shumë standardeve universale penalo-juridike të implementuara në legjislacionet nacionale penale (abolimi i dënimit me vdekje, ndalimi i torturës, garancitë procesore etj). Bëhet fjalë për norma dhe standarde me të cilat definitivisht është shtypur koncepti i pushtetit represiv të *shtetit* si shprehje e *sovrانيتetit* absolut dhe të pakufizuar.

Kuptimi themelor i këtij funksioni të ri përbëhet nga: e drejta penale e mbron individin nga të gjithë vëniet dorë mbi liritë dhe të drejtat e tij, por ajo nuk nënkupton vetëm mbrojtjen nga sulmet e individëve, por edhe nga keqpërdorimi i vet pushtetit! Mu aspekti i dytë e vë të drejtën penale bashkëkohore në një provim të rëndë: si të mbrohemi nga mbrojtësit tanë? Duke e përcaktuar sferën e ndalesës, Kodi penal njëkohësisht e përcakton dhe e garanton sferën e të lejuarës, lirisë. Ajo

është jashtë zonës së represionit penal juridik dhe paraqet sferë autonome të shoqërisë së lirë civile! Kodi penal sipas saj është barrierë e patejkalueshme për dënimin e së drejtës shtetërore. Por, ky postulat (lejohej gjithçka që nuk është e ndaluar) mund të funksionon vetëm në kushte të zhvillimit *demokratik të shtetit juridik*, me të gjithë garancitë politiko-juridike për kontroll shtetëror të pushtetit dhe në relacion me përcaktimin e ndalesave penalo-juridike! Nëse hapësira e së ndaluarës u lëshohet autorizimeve arbitrare, nëse ligdhënësi është i lirë në krijimin e ndalesave penalo-juridike, ashtu që nuk është patjetër të mbahen kritere dhe kufizime të përcaktuara materiale atëherë funksione garantues nuk ka asnjë vlerë e vërtetë. Kufiri në mes sferës së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ingerencave shtetërore, në mes të drejtave natyrore dhe atyre të imponuara, është shumë i ndijshëm. Ajo më tepër ka natyrë metajuridike se sa formale-juridike. Njohja e funksionit garantues të ligjit për atë shkak është e lidhur me vet karakterin e shtetit dhe konstituimit demokratik të pushtetit, ndarjes së pushtetit dhe gjyqësisë së pavarur si opozitë institucionale, veçanërisht pushtetit ekzekutiv, zbatimi i standardeve universale dhe opozitës qytetare (në lloj të së drejtës civilizuese të rebelimit) kundër tejkalimit të autorizimeve të saj.

### **5. Dilema e sigurisë bashkëkohore të individit, shoqërisë shtetit dhe bashkësisë ndërkombëtare**

Në vitet e tetëdhjeta, si përgjigje e ndërvarësisë së shtuar të subjekteve në bashkësinë ndërkombëtare, neorealitët si Kenet, Valc etj. me teorinë e tyre strukturore të politikës së fuqisë, motivin e sigurisë e vendosën në epiqendër të aksionit të shtetit në sistemin ndërkombëtar anarkik.<sup>6</sup> Ky i fundit, ua shteteve imponoi nocionin se siguri i sigurisë është qëllimi më madhor. Presioni i ndërvarësisë u shkaktoi shqetësime hulumtuesve të problemeve të sigurisë, të cilët në vitet e tetëdhjeta ta u ballafaquan me një subjekt më të gjerë të studimeve të tyre, në mesin e të cilëve edhe nevojën për revidimin e politikave të sigurisë, që kanë të bëjnë me realitetin e organizatave politike anarkiste në sistemin ndërkombëtar anarkist. Manifestimi i jashtëm i përpjekjeve për qasje gjithëpërfshirëse, në drejtim të analizës dhe të kuptuarit të sigurisë moderne, u përfshi me idenë për siguri të përbashkët , e cila formën e saj të parë publike e mori nga Komisioni i OKB-së 1982, nën kryesimin

<sup>6</sup> Bashkim Dr. Selmani & Mevledin Dr. Mustafi “Sistemet e sigurisë –Sisteme security”, f.19-37 Furkan ISM Shkup, 2016.



e ish-Kryeministrit të Suedisë Olaf Palme, duke i shqyrtuar problemet që kanë të bëjnë me armatimin global. Nocioni për siguri të përbashkët, në vigjilje të proceseve të internacionalizimit dhe globalizimit, perceptohet mbi të kuptuarit e kufizuar tradicional të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, si probleme pastër ushtarake, dhe si i këtyre paraqet përpjekje që të sintetizohet logjika e qasjeve reale dhe ideologjike ndaj këtyre problemeve.<sup>7</sup>

### **PËRFUNDIMI**

Në plan të së drejtës penale pozitive, funksioni garantues realizohet me respektimin e parimit të ligjshmërisë, vënien e ndalesave me të cilat dënohet keqpërdorimi i pushtetit, pavarësia e gjykatës dhe mbrojtja ndërkombëtare e lirive dhe të drejtave individuale në rast të shkeljes së tyre nga ana e vetë shtetit. Potencimi i funksionit garantues është ngushtë i lidhur me konceptin liberal të së drejtës penale. E drejta e dënimit është e deleguar, e lëshuar shtetit nga ana e qytetarëve, vetëm kur është e nevojshme për mbrojtjen dhe realizimin e lirive dhe të drejtave të tyre dhe funksionet e përbashkëta të jetës. Ekziston një sere mendimesh teorike mbi përdorimin e vetë nocionit dhe një sërë vështrimesh të ndryshme shkencore për sigurinë, sidomos nëse kemi parasysh se ky nocion përdoret si vlerë themelore e marrëdhënieve ndemjet njerëzve në të gjitha fushat e jetës dhe të punës. Këtu buron edhe nevoja e përdorimit të shumë shtresor të këtij nocioni, i cili ka qëllim themelor ruajtjen dhe sigurinë e qytetarëve. Funksioni kryesor i së drejtës penale është mbrojtja e individit dhe shoqërisë nga sjelljet me të cilat sulmohen liritë dhe të drejtat individuale dhe funksioni i përbashkët i jetës, apo me fjalë të tjera, funksioni mbrojtës i së drejtës penale është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti.

Në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve dhe formave të krimit të organizuar, nisur nga mënyra e organizimit dhe realizimit të këtyre veprave në kushtet aktuale dhe nga përvoja e fituar në planin

---

<sup>7</sup> Shih po ashtu: F. H. Hinsley, *Power and Pursuit of Peace*. Cambridge University Press, Cambridge, 1963, f. 20–29; Walter Schiffer, *The Legal Community of Mankind: A Critical Analysis of the Modern World Organization*. Columbia University Press, New York, 1954, f. 3, etj.; Inis L. Claude Jr., *Swords në Plowshares. The Problems and Progress of International Organization*. Random House, New York, 1956, f. 44, etj.; Hueng-Soon Park, *Collective Security and International Order: The Role of the United Nations in the Korean 1950 and the Persian Gulf War 1990*. University of South Carolina, 1993, f. 18, etj.

ndërkombëtar dhe të brendshëm, një rol vendimtar luan identifikimi, sigurimi, ruajtja dhe administrimi në kohë reale, sa me afatgjate dhe i saktë i informacionit dhe provave lidhur me burimet dhe mekanizmat e telekomunikimit në çdo formë të grupeve kriminale dhe pjesëtareve të tyre. Kjo duhet ta zgjidhë dilemën e sigurisë bashkëkohore të individit, shoqërisë shtetit dhe bashkësisë ndërkombëtare, nga aspekti i normave kulturore për secilën shoqëri shtet ndaras, ndërkaq në të njëjtë kohë kjo do të shqyrtonte një kontekst të gjerë universal të tërë bashkësisë humane. Deri në ditët e sotme, zhvillimi gjithnjë e më shumë e pengon efektivitetin e zgjidhjes së problemeve të sigurisë bashkëkohore në nivel të shtetit komb individual dhe në këtë drejtim e gjithë bashkësia ndërkombëtare të jetë e varur, para së gjithash prej kushteve kulturore dhe civilizuese, të cilat kërkojnë një mirëkuptim gjithëpërfshirës të rreziqeve ekzistuese, kundërshtimeve dhe konflikteve si produkt i domosdoshëm i pluralizmit dhe shtimit të ndërlidhjes më të madhe të të gjitha qenieve të gjalla në shoqërinë bashkëkohore dhe natyrën.

### **Conclusion**

In the plan of positive criminal law, guarantee function is implemented with the respecting of the principle of legality, the imposition of restrictions which condemn misuse of powers, the independence of judges and international protection of individual rights and freedoms in case of their violation by state itself. Emphasizing of the guarantee function is closely linked to the liberal concept of criminal law. The right of the penalty is delegated, issued to the state by citizens, only when is necessary for the protection and realization of human rights and freedoms and their common life functions. There is a series of theoretical opinions on the use of the term itself and a number of different scientific glimpses on safety, especially if we take into consideration that this notion is used as a fundamental value of the relationship between people in all areas of life and work. Here stems the necessity of multi-layered use of this notion, which aims underlying safety and security of citizens. The main function of criminal law is to protect individuals and society from behaviors that attacks freedoms and individual rights and common life function, or in other words, the protective function of criminal law is protection of society from crime.

In the prevention, detection and investigating of crimes and forms of organized crime, starting from the way of organization and imple-

mentation of these works in current conditions and the gained experience in the international and domestic plan, a crucial role plays identification, security, maintenance and administration in real time, as long and exact information and evidence regarding the sources and mechanisms of telecommunications in any form of criminal groups and their members. This should solve the dilemma of contemporary security of the individual, society, state and the international community, in terms of cultural norms for each society-state separately, while at the same time it will consider a broader universal context of the whole human community. Until today, the development increasingly hinders the effectiveness of solving the problems of contemporary security at the level of the individual nation state and in this regard the entire international community to be dependent, first of all from the cultural and civilization terms, which requires an all inclusive understanding of existing risks, contradictions and conflicts as indispensable product of pluralism and added greater interconnection of all living beings in modern society and nature.

#### **BIBLIOGRAFIA**

1. Alfredson, Gundumur et. Al. 1999. The Universal Declaration of Human Rights. Oslo: Scandinavian University Press.
2. Alston, Philip ed. 1999. The EU and Human Rights. Oxford: Oxford University Press.
3. Alston, Philip and James Crawford eds. 2000. The Future of UN Human Rights Treaty Monitoring. Cambridge: Cambridge University Press.
4. Andreopoulos, George J. and Richard Pierre Claude. 1997. Human Rights Education for Twenty-First Century. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
5. An-Na'im, Abdullahi Ahmed ed. 1992. Human Rights Cross-cultural Perspectives, A Quest for Consensus. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
6. Asia-Europe Foundation ASEF. 2000. The Third Informal ASEM Seminar on Human Rights. Singapore.
7. Baefsky, Anne F. 2002. How to Complain to the UN Human Rights Treaty System. Transnational Publishers.

8. Bankie, B.F., Marias and J. T. Namiseb comp. 1998. Towards Creating a Sustainable Culture of Human Rights: the Southern African human rights reader. Windhoek: Macmillan.
9. Baxi, Upendra. 1994. Inhuman Wrong and Human Rights: Unconventional Essays. Delhi: Har-Anand Publications.
10. Baxi, Upendra. 2002. The Future of Human Rights. Oxford University Press.
11. Benedek, Wolfgang ed. 1999. Human Rights in Bosnia and Herzegovina, Theory and Practice. The Hague: Martinus Nijhoff Publishers.
12. Benedek, Wolfgang and Alice Yotopoulos-Marangopoulos eds. 2003. Anti-Terrorist Measures and Human Rights, Kulwer Law International upcoming.
13. Benedek, Wolfgang, Esther M. Kissaakye and Gerd Oberleitner. 2002. The Human Rights of Women: International Instruments and African experiences. London: Zed Books.
14. Bjekovic, Sinisa, Vedrana Spahic-Vrkas and Nebojsa Vucinic eds. 2003. Human Rights for Non-Lawyers. Sarajevo: DD Stamparija Svjetlost- Fonica.
15. Buergenthal. Thomas, Diana Shelton and David Stewart. 2002. International Human Rights in a Nutshell. St. Paul: West Group.
16. Buergenthal. Thomas, Diana Shelton. 1995. Protecting Human Rights in the Americas Cases and Materials. 4th rev. ed., Kehl: Engel.
17. Caney, Simon and Peter Jones eds. 2001. Human Rights and Global Diversity. London: Frank Cass Publishers.
18. Hall, Jerome, Mueller, Gerhard, - Criminal Law and Procedure, Second Ed., Indianapolis 1965
19. Hart, H.L.A., - Punishment and Responsibility, Essays in the Philosophy of Law, Oxford 1968
20. Horvatiq, dreljko, - Izbor kazne u jugoslovenskom krivičnom pravu i sudskoj praksi, Zagreb 1980
21. Horvatiq, dr Zheljko, Novoselec, dr Petar, - E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2., Zagreb 2001
22. Ignatov, A.N., Krasikov, Jo.A., - Kurs rossijskogo ugolovnogogo prava, Tom 1, Obccajjja častxx, Moskva 2001
23. Jakobs, Günther, - Studien zum fahrlässigen Erfolgsdelikt, Berlin 1972.

24. Jescheck, Hans-Heinrich, Weigend, Thomas, - Lehrbuch des Strafrechts, Allg. Teil, Fünfte Aufl., Berlin 1996

25. Kambovski, dr Vlado, - Problematika e lëshimit në të drejtën penale Shkup 1982 (cit.- Kambovski) Reforma penalo-juridike para sfidave të shek XXI Shkup 2002 (Kambovski)

26. Kaufmann, Arthur,- Das Schuldprinzip, Eine strafrechtlich-rechtsphilosophische Untersuchung, Heidelberg 1961.

27. Kienapfel, dr Diethelm, Höpfel, dr Frank, - Grundriss des österreichischen Strafrechts, Allg. Teil, Wien 2003.